

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË –Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** dhe me pjesëmarrjen e Sekretares juridike Valbone Hoxha, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “S. I. V.”- me seli P., të cilën e përfaqëson i autorizuari B. M., me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurit L.(D.) L. nga Gj. rr.“L. D.i” p.n, për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 2.560,00 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.06.08.2018, në prezencën e përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të paditurit, me **dt.06.09.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

MIRATOHET kërkesë padia e paditëses Kompania e Sigurimeve “S.I. V.”- me seli P. dhe **DETYROHET** i padituri L.(D.) L. nga Gj., që në emër të rimbursimit të dëmit, palës paditëse, t’ia paguaj shumën prej **2.560,00 € (dymijë e pesëqind e gjashtëdhjetë euro)**, me kamatë përkatëse ligjore të cilat e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara në Bankë, në afat mbi një vit, pa destinim të caktuar e cila fillon të rrjedhë nga dt.26.12.2017 (dita e parashtrimit të padisë) e tutje gjer në pagimin definitiv, si dhe në emër shpenzimeve procedurale shumën prej **160,00 € (njëqind e gjashtëdhjetë euro)**, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja në padi ka theksuar se i padituri me dt.06.11.2017, rreth orës 06.30, në rr. “N. T.”, në Gj., duke drejtuar automjetin B. 3 .. me targa ..-...-..., pronë e tij, pa poseduar leje të vlefshme për drejtimin e kësaj kategorie të automjeteve, ka shkaktuar aksident trafiku, dhe si pasojë e saj e ka shkaktuar dëm material në automjetin M. E.me targa ..., pronë e G. D., në automjetin O. A. me targa ..., pronë e I. D., si dhe në automjetin V. G. me ... pronë e V. U.. Mënyrë se si ka ardhur deri te shkaktimi i këtij aksidenti, me detajisht është përshkruar në raportin policor të policisë. Automjeti, shkaktar i aksidentit, në momentin e ndodhjes së aksidentit ka qenë i siguruar te paditësja, në bazë të kontratës mbi sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë, për heqjen e përgjegjësisë ndaj palëve të treta të dëmtuara. Mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm të auto përgjegjësisë, për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjeteve motorike, paditësja palëve të treta të dëmtuara i ka kompensuar dëmet materiale, që janë shkaktuar si pasojë e këtij aksidenti në automjetin M.E. me targa, pronë e G.D., në shumë prej 668.00 €, në automjetin O. A. me targa ..., pronë e I. D., në shumë prej 1,741.00€, si dhe në automjetin V. G. me targa ..., pronë e V. U., në shumë prej 151.00 €. Meqë i padituri ditën kritike ka drejtuar automjetin pa poseduar leje të vlefshme për drejtimin e kategorisë së caktuar të automjeteve, me këtë rast, në kuptim të dispozitave ligjore kemi të bëjmë me humbje të mbulesës siguroese dhen njëkohësisht për të drejtën e paditëses për regresimin e mjeteve nga paditësi, të paguara palëve të treta për zhdëmtim.

Përfaqësuesi i paditëses në shqyrtimin përgatitor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, në pika të shkurtra elaborojmë padinë, duke theksuar se me dt.06.11.2017, i padituri duke drejtuar B. shkaktonte aksident trafiku ku ky fakt vërtetohet nëpërmes raportit të aksidentit me nr. ER ... dt.06.11.2017, i padituri në kohë e shkaktimit të aksidentit sipas dokumentacionit dhe provave vërtetohet se nuk ka poseduar patentë shofer të vlefshme për drejtimin e automjetit, i njëjti sipas policisë së trafikut ka qenë shkaktar kryesor i këtij aksidenti. Palët e dëmtuara nga ky aksident paditëses ju kanë drejtuar me kërkesë për kompensim dëmi, të njëjtat kërkesa nga paditësja janë shqyrtuar dhe palëve të dëmtuara i është kompensuar dëmi, këtë fakt e vërtetojmë me deklaratat e

pranimit të kompensimit dhe urdhër pagesën për kompensim dëmi. Po ashtu transaksioni bankar, të cilat ja kemi bashkëngjiti si prova kësaj padie. Nëse kontestohet baza konkretisht posedimi i patentë shoferit, Gjykata ta obligoi të paditurin në dorëzimin e kopjes për të njëjtin, e nëse kontestohet pafajësia rreth shkakut të aksidentit, me qëllim të vërtetimit të këtij fakti propozojmë Gjykatës që të caktohet ekspertizë komunikacioni. Me që i padituri siç u theksua më lartë nuk kishte patentë shofer për drejtimin e automjetit të kategorisë B, konform ligjit për sigurimin e detyrueshme nga auto përgjegjësia, neni 14 humb mbulesa sigures dhe për paditësen këtu është baza ligjore për rimbursimi – regresin ndaj palëve të dëmtuara, andaj nga kjo Gjykatë kërkojmë që në shqyrtimin gjyqësor të administrohen provat materiale të dorëzuara dhe pas vërtetimit të gjendjes faktike bie vendi ku e detyron të paditurin që paditëses të ia paguaj shumën prej 2.560,00 € me kamatë ligjore, po ashtu kërkojmë shpenzimet procedurale.

Përfaqësuesi i paditëses në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, konsiderojmë se baza juridike u vërtetua e kërkesë padis, po ashtu me provat e administruara është vërtetuar edhe vlera e saj. Lidhur me shpenzimet e procedurës kërkojmë shpenzimet për dy seanca gjyqësore, për përfaqësim në cilësi të avokatëve, për padi shpenzimet për taksën gjyqësore sipas TA si dhe për ekspertizë.

I padituri në përgjigje në padi të dhënë me datën 22.02.2018 ka theksuar se kundërshtoi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit. Të gjitha pretendimet e parashtruara në padi i kundërshtojmë. Kundërshtoi rregulluesin, lartësinë dhe legjitimitetin e sajë. Paditësi padinë e bazon në prova dhe fakte të mangëta. Padia e paditësit nuk ka mbështetje në asnjë provë materiale. Kjo e metë dhe kjo parregullsi padinë e paditësit e bën të mangët dhe si të tillë do duhej të hidhet poshtë si e pa rregullt. Pa u lëshuar në të dhënat tjera, vetëm nga të cekurat rezulton se padia në tërësi është e pa bazë ashtu që paditësi do duhej të kujdesej që mos të krijoj shpenzimet të pa nevojshme me të cilat do duhej të ngarkohet. Andaj, edhe një herë kërkoj nga paditësi që të rishikoi pozicionin e tij për faktin se pretendimet e theksuara në padi në raport me të paditin nuk qëndrojnë. Nga të cekurat, propozoi Gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazë.

I padituri në shqyrtimin përgatitor ka deklaruar se e kundërshtoi kërkesë padinë pasi që nuk e ndiej veten fajtor në shkaktimin e këtij aksidenti. Po ashtu shton se në momentin e shkakut të aksidentit nuk kam pa patentë shofer në atë kohë, ndërsa tani e posedoi. Ndërsa nuk e kundërshtoi propozimin për caktimin e ekspertit, në mënyrë që të vërtetohet fajësia.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 423.4 të ligjit për Procedurën Kontestimore nr.38/2008, të publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikën së Kosovës” me dt.20.09.2008, shqyrtimin kryesor u mbajti në mungesë të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flete dërgesa, të cilën e ka pranuar me dt.24.07.2017, mirëpo mos prezencën nuk e ka arsyetuar, ndërsa me propozimin e palës paditëse Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të paditurit dhe pas vlerësimit të provave veç e veç dhe në bazë të rezultatin të procedimit, mbështetur edhe në nenin 8 të LPK-së, vërtetoi se kërkesë-padia e paditëses është në tërësi e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata në shqyrtimin kryesor bëri administrimin e provave si më poshtë; Raportit të aksidentit të lëshuar nga Policia e Kosovës, me nr. ER ... të dt. 06.11.2017, Vazhdim i raportit të aksidentit të lëshuar nga Policia e Kosovës, me nr. ER ... të dt. 06.11.2017, 14 foto në formatin A. bardhë e zi ku shihet vendi i aksidenti dhe dëmet e pësuar si pasojë e aksidentit, Konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga KS ”S...” me dt. 13.11.2017, Deklaratë i pranimit të vlerës për dëm shpërblim, të dëmtuarit G. D. me dt. 30.11.2017, pranë KS ”S.” P., Urdhër pagesë dëmi e dt. 01.12.2017 lëshuar nga KS ”S.a” për të dëmtuarin G. D., Tabela e transferit bankar e dt. 01.12.2017, në emër të dëmtuarve G. D., V. U. dhe I. D., Deklaratë i pranimit të vlerës për dëm shpërblim të lëshuar nga KS “S.” për të dëmtuarin I.D. me dt., 14.12.2017, Urdhër pagesë dëmi të lëshuar nga KS “S.” për të dëmtuarin I. D. me dt. 15.12.2017,

Deklaratë për pranimin e vlerës për dëm shpërblim të përpiluar nga KS "S." me të dëmtuarin V. U. me datën 08.12.2017, Urdhër pagesë dëmi të lëshuar nga KS "S..." për të dëmtuarin V.U. me dt. 11.12.2017, Ekspertizën e ekspertit të komunikacionit L. S., e përpiluar me dt. 17.07.2018.

Baza juridike e kërkesë-padisë u vërtetua nga provat si Raportit të aksidentit të lëshuar nga Policia e Kosovës, me nr. ER ... të dt. 06.11.2017, Vazhdim i raportit të aksidentit të lëshuar nga Policia e Kosovës, me nr. ER ... të dt. 06.11.2017, 14 foto në formatin A.bardhë e zi ku shihet vendi i aksidenti dhe dëmet e pësuar si pasojë e aksidentit, po ashtu nga Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit L. S. e përpiluar me dt.17.07.2018, ku ka dhënë mendimin se shkaktar kryesor është drejtuesi i veturës (A) B. 3C, për këtë arsye; Devijimi nga drejtimi i lëvizjes; drejtuesi i veturës (A) gjatë lëvizjes në rrugën "N.T." me veturën e tij ka bërë lëshime duke mos u kujdesur në këtë rast për pozitën, drejtimin dhe shpejtësinë e veturës së tij ku si pasojë vetura (A) ka devijuar duke u bartur nga shiriti i djathtë në shiritin e majtë dhe ka përfunduar duke i goditur tri vetura e parkuara në mënyrë të rregullt përgjatë rrugës. Si pasojë e këtij veprimi ka pësuar lëndime trupore vetë drejtuesi i veturës (A) si dhe janë shkaktuar dëme materiale në veturat e aksidentuara dhe në një shtyllë të ndriçimit publik.

Lidhur me lartësinë e kërkesë-padisë – rimbursimin e dëmit gjykata vendimin e vet e bazoi në bazë të provave si Konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga KS "S." me dt.13.11.2017, Deklaratë i pranimit të vlerës për dëm shpërblim, të dëmtuarit G.D. me dt.30.11.2017, pranë KS "S." P. në shumën prej 668.00€, Urdhër pagesë dëmi e dt.01.12.2017 lëshuar nga KS "S." për të dëmtuarin G.D. në shumën prej 668.00€, Tabela e transferit bankar e dt. 01.12.2017, në emër të dëmtuarve G. D.në vlerën prej 668.00 €. Deklarata e pranimit të vlerës për dëm shpërblim të lëshuar nga KS "S." për të dëmtuarin I.D. me dt.14.12.2017, në shumën prej 1.741.00 €, Urdhër pagesë dëmi të lëshuar nga KS "S..." për të dëmtuarin I.D.me dt.15.12.2017, në shumën prej 1.741.00 €, Deklaratë për pranimin e vlerës për dëm shpërblim të përpiluar nga KS "S." me të dëmtuarin V.U. me datën 08.12.2017, në shumën prej 151.00 €, Urdhër pagesë dëmi të lëshuar nga KS "S." për të dëmtuarin V. U. me dt.11.12.2017, në shumën prej 151.00 €, ku vlera e dëmit për të gjithë të dëmtuarit arrin shumën prej 2.560.00 €, të cilën shumë paditësja iu ka paguar të dëmtuarve, për shkak të aksidentit të cilin e ka shkaktuar i padituri.

Lidhur me pretendimet e të paditurit i cili e ka kundërshtuar padinë duke theksuar se nuk e ndjej vetën fajtor, Gjykata këtë pretendim nuk e mori për bazë pasi që nga provat e lartcekura të siguruar nga Policia e Kosovës si dhe nga ekspertiza e përpiluar nga eksperti i komunikacionit është vërtetuar se shkaktar i aksidentit ka qenë i padituri, po ashtu kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësi në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka pasur patentë shofer për vozitjen e automjetit edhe pse e kishte moshën madhore.

Lidhur me përgjegjësin e paditëses për të kompensuar personat e dëmtuar në raste të tilla të aksidentit ky detyrim në rast se shkaktari i aksidentit ka mbulesë të sigurimit i cili përgjigjet ndaj palëve të treta ku në rastin konkret automjeti ka qenë i siguruar tek paditësja, ndërsa i padituri në datën e ndodhjes së aksidentit lëndor nuk ka poseduar patentë shofer të kategorisë "B" dhe ka qenë i siguruar tek Kompania e Sigurimeve "S..." – P...

Gjykata konstaton se duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia Nr.04/L-018 të dt.23.06.2011, konkretisht në nenin 14 paragrafi 1.2 ku theksohet se i siguruari i humb mbulesën siguruese se "drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtimin e mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimin" andaj i padituri e ka humbur mbulesën e sigurimit pasi që i njëjti e ka drejtuar automjetin pa poseduar patentë shofer, ku edhe vet e ka pranuar se nuk ka pasur patentë shofer.

Gjykata vërteton se duke pasur parasysh faktin se aksidenti lëndor ka ndodhur me fajin e të paditurit i cili nuk iu ka përmbajtur rregullave të ligjit mbi komunikacionin dhe në momentin e shkakimit të aksidentit i njëjti e ka humbur mbulesën siguroese pasi që nuk ka poseduar patentë shofer, dhe në rastin konkret nga ana e tij ekziston lidhja direkt kauzave me dëmin e shkakuar, rrjedhë edhe konkludimi se pala paditëse ka të drejtë të regresohet për shumën e paguar lidhur me dëmet të cilat i kanë pësuar G.D. në shumën prej 668.00 €, I.D. në shumën prej 1.741.00 €, dhe V.U. në shumën prej 151.00 €, në shumën e përgjithshme prej 2.560.00 €, për çka edhe i padituri është i detyruar që palës paditëse t'ia regresi shumën prej 2.560.00 €, si vlerë e kërkesë-padisë, së bashku me kamatat ligjore dhe shpenzimet procedurale, duke u bazuar në dispozitën e nenit 14 paragrafi 1.2 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia Nr.04/L-018 dhe nenit dhe nenit 136 pika 1 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muarr konform nenit 452.1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranuan shpenzimet procedurale në emër të taksave gjyqësor për padi dhe aktgjykim shumën prej 40,00 € dhe shpenzimet për ekspertizë në shumën prej 120.00 €, në shumën e përgjithshme prej 160.00 €.

Nga të lartcekurat u vendos si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.737/17 të dt.06.09.2018

GJYKATËSI,
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi lejohet e drejta e ushtrimit të ankesës, në afat prej 15 ditëve , Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.